

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË TË BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR SHBB**  
**"BIOVAJ TREVLLAZËR"**

Në mbështetje të ligjit nr.38, datë 05.04.2012 "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor" si dhe ligjit nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" sot në datë 27/03/2023 hartohet ky statut prej antarëve të shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor " BIOVAJ TREVLLAZËR ". Kjo shoqëri është një organizëm i krijuar me vullnetin e lirë të antarëve të saj.

Kjo shoqëri është një organizëm i krijuar me vullnetin e lire të antarëve të saj, jo politike dhe e pavarur, me përberjen e mëposhtme:

1. Jetnor Meminaj me nr ID I10210060P
2. Razip Meminaj me nr ID I20912040K
3. Aurel Myrtaj me nr ID J10619069H
4. Sokol Myrtaj me nr ID G30220277C
5. Pangrac Mukaj me nr ID G10202057W
6. Taulant Myrtaj me nr ID I20829044J
7. Ermir Lazaj me nr ID I91229047B
8. Pirot Mukaj me nr ID G10205299B
9. Gëzim Lamaj me nr ID G01003111V
10. Jonian Meminaj me nr ID I70929055J


**NENI 1**  
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

"Emërtimi shoqërisë do të jetë Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor SHBB "BIOVAJ TREVLLAZËR" Inicialet e Shoqërisë do të jenë SHBB "BIOVAJ TREVLLAZËR" . Shoqëria ka vulën dhe logon e saj dhe ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

**NENI 2**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Objekti i Shoqërisë është

- Kultivimi i ullirit, prodhimi, përpunimi dhe marketingu i vajit të ullirit.



- Përmirësimi dhe organizimi i kultivimit të vreshtave, pemëve frutore dhe të produkteve bujqësore në përgjithësi me qëllim rritjen e sasisë dhe cilësisë së prodhimit, si dhe për tregëtimin e produkteve dhe nënprodukteve të tyre.
- Nxitja dhe organizimi i të gjitha aktiviteteve që lidhen me prodhimin dhe tregëtimin e prodhimeve të fermerve.
- Ngritja e industrisë përpunuese, kryesisht për produkte që rriten në mënyrë organike në natyrë si dhe kultivimin, magazinimin, ruajtjen, përpunimin, paketimin, ambalazhimin dhe tregëtimin e tyre.
- Sigurimi dhe furnizimi e fermerve me inpute cilësore dhe me çmime të arsyeshme.
- Veprimtari në mbështetje të komunitetit duke përfshirë shpërndarjen e ndihmave dhe mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara dhe shtresave në nevojë, mbështetje në përmirësimin e infrastrukturës rurale dhe bujqësore.
- Zhvillimi i agroturizmit në zonë dhe i turizmit në përgjithësi.

### NENI 3

#### SELIA DHE TERRITORI I VEPRIMTARISË

Selia e shoqërisë do të jetë në Vlorë, Njësia Administrative Novoselë, Fshati Trevllazër, objekt privat. Veprimtaria e saj do të shtrihet në Njesinë Administrative Novoselë si dhe kudo ku shtrihet antarësia e saj.

### NENI 4

#### KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë SHBB" BIOVAJ TREVLLAZËR", është e pakufizuar.

### NENI 5

#### KAPITALI

Kapitali minimal i Shoqërisë është 100.000 lek, kapital i cili përbëhet nga kontributet e antarëve i cili është në para.

1. Kapitali ndahet në pjesë të cilat zotërohen nga antarët dhe përfaqësojnë vlerën e kontributit të tyre në kapital.
2. Kontributet në natyrë shprehen në vlerë ekonomike mbi bazë të një raporti vlerësimi të bërë nga një ekspert.
3. Antarët janë pronarë të aseteve të tyre në kapitalin e shoqërisë duke qënë kështu dhe pronarë të Shoqërisë në raport me kontributet në kapital.

4. Kapitali përketes mund të shitet, dhurohet apo lihet trashëgimi nga secili prej anëtareve të Shoqërisë
5. Kapitali mund të ndryshohet me anë të kontributeve shtesë të antarëve aktual, me shtimin e numrit të anëtarëve, me kapitalizmin e fitimeve apo me çdo mënyrë tjetër të ligjshme.

Nr	ID	Ortakët e shoqërisë	Numri i pjesëve	Përqindja e pjesëmarrjes	Kontributi në lekë
1	I10210060P	Jetnor Meminaj	1 (një pjesë)	10.00%	10.000
2	I20912040K	Razip Meminaj	1 (një pjesë)	10.00%	10.000
3	J10619069H	Aurel Myrtaj	1 (një pjesë)	10.00%	10.000
4	G30220277C	Sokol Myrtaj	1 (një pjesë)	10.00%	10.000
5	G10202057Ë	Pangrac Mukaj	1 (një pjesë)	10.00%	10.000
6	I20829044J	Taulant Myrtaj	1 (një pjesë)	10.00%	10.000
7	I91229047B	Ermir Lazaj	1 (një pjesë)	10.00%	10.000
8	G10205299B	Pirot Mukaj	1 (një pjesë)	10.00%	10.000
9	G01003111V	Gëzim Lamaj	1 (një pjesë)	10.00%	10.000
10	I70929055J	Jonian Meminaj	1 (një pjesë)	10.00%	10.000
<b>Totali</b>			<b>10</b>	<b>100.00%</b>	<b>100,000</b>

6. Secili anëtar ka detyrime të shlyejë plotësisht vlerën e kontributit të tij në momentin e anëtarësimit

#### NENI 6

#### ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË MBAS TRANSFERIMIT

Organet Drejtuese të Shoqërisë janë:

1. Asambleja e përgjithshme
2. Administratori

#### NENI 7

#### MËNYRA E SHPËRNDARJES TË SHOQËRISË PAS TRANSFERIMIT

Shoqëria shpërndahet me vendim të mbledhjes së përgjithshme të thirrur nga Administratori. Procedura e ndjekur për shpërndarjen e saj përcaktohet në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria shpërndahet në këto raste;

-Kur numri i antarëve është nën shtatë veta.

-Kur qëllimi i saj është përmbushur apo nuk ka mundësi të përmbushet, pasi ka humbur aftësi pagese.

-Në raste shpërndarjeje të shoqërisë, ajo pushon veprimtarinë e saj dhe vihet në likuidim nga komisioni i likuidimit i cili formohet sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi.

Ky akt themelimi, hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë në QKB. Në këtë ditë shoqëria njihet edhe si person juridik. Të drejten e përfaqësimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit të shoqërisë për të bërë regjistrimin e saj e ka Administratori i saj.

### PËRFAQËSIA THEMELUESE

Jetnor Meminaj

Razip Meminaj

Aurel Myrtaj

Sokol Myrtaj

Pangrac Mukaj

Taulant Myrtaj

Ermir Lazaj

Pirot Mukaj

Gëzim Lamaj

Jonian Meminaj

